

United Nations
Nations UniesInternational Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia
Tribunal Penal International
pour l'ex-Yougoslavie

(IT-03-66-R77)

BEQË BEQAJ**BEQË BEQAJ***Shpallur fajtor për shpërfillje të Tribunalit në çështjen
Prokurori k. Limajt dhe të tjerëve. (IT-03-66)*I afërm i Isak Musliut, i akuzuar në çështjen *Prokurori k. Limajt dhe të tjerëve*.

- Dënuar me katër muaj burgim

*Krimet për të cilat u shpall fajtor:***Shpërfillje e Tribunalit (Rregulla 77(A) (iv) e Rregullores së Procedurës dhe Provave)**

- Beqë Beqaj me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyri ndaj një dëshmitari dhe ndaj ushtrimit të drejtësisë në çështjen *Limajt dhe të tjerë*.

Aktakuza	Fillestare: 29 tetor 2004, u publikua më 4 nëntor 2004; u ndryshua: 8 nëntor 2004
U arrestua	19 tetor 2004
U transferua në TPNJ	4 nëntor 2004
Paraqitja e Parë	8 nëntor 2004, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	5 maj 2005, u dënua me katër muaj burgim
Dënimi është kryer	Koha e kaluar në paraburgim u llogarit brenda kohëzgjatjes së burgimit; ai u lirua menjëherë

TË DHËNA

Numri i ditëve të procesit gjyqësor	4
Dëshmitarë të thirrur prej Prokurorisë	3
Dëshmitarë të thirrur prej Mbrojtjes	0

PROCESI GJYQËSOR	
Filloi	25 prill 2005
Argumentet përmbyllëse	2 maj 2005
Dhoma Gjyqësore I	Kryegjykatës Amin El Mahdi, Gjykatësi Liu Daqun, Gjykatësi György Szénási
Përfaqësues të Prokurorisë	David Akerson, Jason Dominguez
Avokati i Mbrojtjes	Tjarda Eduard van der Spoel
Aktgjykimi	5 maj 2005

ÇËSHTJE QË KANË LIDHJE <i>prej zonës gjeografike</i>
LIMAJ dhe të tjerët. (IT-03-66)

AKTAKUZA DHE AKUZAT

Në përputhje me Rregullën 77 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, Tribunali mund të kryejë procese në lidhje me shpërfillje ndaj gjykatës. Për sa i përket shpërfilljes juridiksioni i Tribunalit nuk është përcaktuar shprehimisht në Statut. Mirëpo është vërtetuar definitivisht se Tribunali zotëron kompetencë të vetvetishme që buron prej autoritetit të vet ligjor, për të mundësuar mospengimin e ushtrimit të juridiksionit të vet përcaktuar shprehimisht në Statut dhe për garantimin e detyrave të veta themelore gjyqësore. Duke qenë gjykatë ndërkombëtare penale Tribunali zotëron kompetencën e vetvetishme përkundrejt veprimeve ndërhyrëse ndaj ushtrimit të drejtësisë, ku përfshihen pengimi, paragjyrimi ose shpërdorimi i ushtrimit të drejtësisë. Rrjedhimisht kushdo që me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyrë ndaj ushtrimit të drejtësisë prej Tribunalit, mund të shpallot fajtor për shpërfillje të Tribunalit.

Në tetor 2004 Beqë Beqaj u mor në pyetje prej hetuesve të Prokurorisë si i dyshuar për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve. Më 21 tetor 2004, Prokuroria dorëzoi aktakuzën kundër Beqë Beqajt, e cila u konfirmua më 29 tetor 2004 dhe u mbajt e mbyllur me vulë. Më 4 nëntor 2004 u shfuqizua konfidencialiteti i aktakuzës. Më 8 nëntor 2004, Dhoma autorizoi gojarisht ndryshimin e aktakuzës për të korigjuar shqiptimin e emrit të të akuzuarit

Sipas aktakuzës, Beqë Beqaj, personalisht, dhe me të tjerë, nxiti, u orvat të kryente, kreu ose bashkëpunoi në kryerjen e shpërfilljes së Tribunalit. U pretendua se prej 17 shkurtit 2003 deri më 19 tetor 2004, Beqë Beqaj kishte ndërhyrë ndaj dy dëshmitarëve të mundshëm në procesin gjyqësor *Limaj dhe të tjerët* gjashtë herë dhe rrjedhimisht ai kishte ndërhyrë me vetëdije dhe qëllimisht ndaj ushtrimit të drejtësisë në këtë çështje nëpërmjet kërcënimit, frikësimit, ofrimit të shpërblimit ose ndryshe nëpërmjet ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Prokuroria theksoi se kjo çështje kryesisht kishte të bënte me ndërhyrje ndaj dëshmitarëve dhe ofrim shpërblimi dhe jo kërcënime apo frikësime.

Beqë Beqaj u paraburgos si i dyshuar në Prishtinë nga 19 tetor 2004 deri më 29 tetor 2004 me kërkesë të Prokurorisë dhe në bazë të një urdhërese të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Ai u transferua në paraburgimin e Tribunalit më 4 nëntor 2004. Më 8 mars 2005, Beqë Beqaj u lirua përkohësisht në Kosovë. Ai u kthye në paraburgimin e Tribunalit më 20 prill 2005 për të qenë i pranishëm në procesin gjyqësor.

GJYKIMI

Gjykimi filloi më 25 prill 2005 dhe përfundoi më 2 maj 2005.

Gjatë procesit gjyqësor Prokuroria paraqiti tre dëshmitarë për vërtetimin e pretendimit të vet se Beqë Beqaj ishte orvatur të bindte dëshmitarët që të tërhiqnin deklaratat e tyre kundër të akuzuarve në çështjen *Limaj dhe të tjerë*. Mbrojtja vendosi të mos thëriste dëshmitarë dhe Beqë Beqaj dha një deklaratë ku mohoi akuzat që përfshiheshin në aktakuzë.

AKTGJYKIMI I DHOMËS GJYQËSORE

Paraprakisht Dhoma Gjyqësore shqyrtoi kundërshtitë e Mbrojtjes në lidhje me veprën penale të shpërfilljes, duke ritheksuar faktin se zotëronte kompetencë të vetvetishme për ndëshkimin e sjelljes që priret të pengojë, paragjykojë ose shpërdorojë ushtrimin e drejtësisë.

Në lidhje me incidentet e pretenduara prej Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore nuk gjeti prova në mbështetje të pretendimeve se Beqë Beqaj kishte kërcënuar, frikësuar ose u kishte ofruar shpërblim dëshmitarëve. Gjithsesi u konkludua se në lidhje me një dëshmitar ekzistonin prova jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Beqë Beqaj, me vetëdije dhe qëllimisht kishte ndërhyrë ndaj atij dëshmitari dhe ndaj ushtrimit të drejtësisë.

Më 5 maj 2005, Dhoma Gjyqësore shqiptoi vendimin, duke e shpallur Beqë Beqajn fajtor për shpërfillje të Tribunalit në bazë të Rregullës 77 (A)(iv) të Rregullores së Procedurës dhe Provave. Ai nuk u shpall fajtor për orvatje dhe nxitje të kryerjes së shpërfilljes së Tribunalit bazuar në Rregullat 77 (A) (iv) dhe (B) të Rregullores së Procedurës dhe Provave. Aktgjykimi me shkrim u bë i disponueshëm më 27 maj 2005

Dënimi: katër muaj burgim

Në kohëzgjatjen e burgimit u llogarit koha e kaluar në paraburgimin e Tribunalit prej Beqë Beqajt dhe Beqë Beqaj u lirua menjëherë pas shqiptimit të aktgjykimit të tij.

Dokument përgatitur prej Shërbimit të Komunikimit. Të gjitha dokumentet themelore të TPNJ-së gjenden në: www.un.org/icty
Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Churchillplein 1, 2517 JW The Hague, Netherlands.